



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**Legjislatura VI**  
**Sesioni pranveror**

---

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike

Mbledhja nr. 39

Prishtinë, më 12.2.2019, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

**Procesverbal**

**Në mbledhje morën pjesë:** Vjosa Osmani-Sadriu, Time Kadrijaj, Danush Ademi, Glauk Konjufca, Fitore Pacolli, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Elmi Reçica, Evgjani Thaçi-Dragusha dhe Zafir Berisha.

**Mungoi:** Sërgjan Mitroviq.

**Pjesëmarrës të tjerë:** Yllka Gashi, praktikante; Agron Hoti, MIE; Agnesa Haxhiu dhe Loren Hyseni, KDI dhe media.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28 dhe 30 janar 2019;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 06/L-148 për Diasporën;
4. Të ndryshme.

**1. Miratimi i rendit të ditës;**

Kryetarja konstatoi se Komisioni e miratoi rendin e ditës.

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 28 dhe 30 janar 2019;**

Kryetarja konstatoi se Komisioni i miratoi procesverbalet nga mbledhjet e mbajtura më 28 dhe 30 janar 2019.

### **3. Shqyrtimi në parim i Projektligji nr. 06/L-148 për Diasporën;**

**Vjosa Osmani-Sadriu**, tha se Projektligji për Diasporën i ka plotësuar kushtet për shqyrtim në parim në komision. Ajo theksoi se janë organizuar disa debate publike, lidhur me këtë projektligj, e takime me ministrinë, ku janë paraqitur shqetësimet dhe propozimet konkrete të komisionit. Komisioni ka miratuar me rastin e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit në fuqi, një sërë rekomandimesh të grupit punues, me qëllim që ato të bëhen pjesë e këtij projektligji. Osmani, tha se ky projektligj përmban edhe pjesët përbërëse, siç janë memorandumit shpjegues, deklaratat për përputhshmërinë me legjislacionin e BE-së si dhe deklaratat financiare, në të cilën thuhet se nuk është paraparë buxhet për implementimin e këtij projektligji, gjë që duhet të merret parasysh gjatë rishikimit të buxhetit.

**Evgjeni Thaçi-Drangusha**, tha se ky projektligj erdhi si rezultat i punës së MDIS, dëgjimeve publike të organizuara nëpër shtetet e ndryshme, në të cilat komisioni pati mundësi të jetë pjesë e tyre gjatë hartimit të projektligjit. Si kryesuese e grupit punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit në fuqi, ajo tha se janë nxjerr 10 rekomandime, nga të cilat disa janë përfshirë e disa jo në draftin e ri dhe shtoi se gjatë punës në mes të dy leximeve, mund të përfshihen edhe rekomandimet tjera që në fund të bëjmë më të mirën për këtë projektligj.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, theksoi se rekomandimet e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për diasporën, janë ngritur në takimin me ministrin dhe në debate jashtë vendit dhe ato mund të amendamentohen gjatë shqyrtimit të projektligjit.

**Doruntinë Maloku-Kastrati**, rekomandimet e miratuara në komision, tha, se ka pritur që të përfshihen në këtë projektligj, ndërsa ato duhet të adresohen përmes amendamenteve, siç janë shqetësimet për qendrat kulturore, çështja e RTK-së si dhe ndryshimi i radhitjes së disa pikave në projektligj. Ajo, tha se pika 4 e nenit 16 të projektligjit, nuk ka qenë fare në nenin 16 të draftit të fundit, prandaj është dashur të përfshihen ndryshimet edhe rekomandimet e komisionit.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, theksoi se rekomandimet e miratuara në komision nga mbikëqyrja e zbatimit të ligjit në fuqi, kemi vendosur që të mbesin në dokumentacionin e komisionit.

**Doruntinë Maloku-Kastrati**, tha se shqetësimet në lidhje me RTK-në i kemi biseduar me ministrin, megjithatë ato prapë nuk janë adresuar në projektligj.

**Fitore Pacolli**, tha se është problem që në projektligj të ndryshohen disa çështje thelbësore përmes amendamenteve e sidomos tek qendrat kulturore, përderisa Qeveria nuk ka plan konkret se si do të operojnë këto qendra kulturore. Me rastin e caktimit të një atasheu, tha se ne kemi ngritur shqetësime rreth operimit të një qendre kulturore për diasporën, përmes një personi, i cili zgjidhet nga Qeveria e Kosovës dhe i cili është i vetëm në marrjen e vendimeve në qendër kulturore. Ajo kërkoi që të dërgohet një studim nga ministria, se këto qendra kulturore nuk do të kenë funksionin sipas modelit që ka qenë problematik dhe se cilat probleme e vështirësi do t'i eliminojnë tani. Ministria do të ketë mundësi të hapë 5 qendra kulturore, bazuar në buxhetin të cilin e ka, ndërsa tani thuhet se nuk ka buxhet të ndarë për vitin 2019, përderisa konsideron se thelb i këtij projektligji janë qendrat kulturore.

Pacolli tha se nëse nuk ka buxhet për zbatimin e këtij projektligji, nuk duhet të shkohet më tutje me këtë projektligj, por ai duhet të kthehet në Qeveri. Qeveria duhet të propozojë një plan të funksionimit të qendrave kulturore, se si do të operojnë ato dhe cili duhet të jetë funksioni i tyre.

**Doruntinë Maloku-Kastrati**, tha se problemi i cili ekziston tek qendrat kulturore e që e kemi vërejtur edhe gjatë vizitave nëpër shumë vende, është nevoja e madhe e mërgimtarëve që të kenë më tepër qendra kulturore. Në Gjermani është shprehur indinjata e mërgimtarëve se me një numër

aq të madh të kosovarëve, nuk ka asnjë qendër kulturore. Duke u ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 8, tha se duhet të kemi parasysh që ku ka shqiptarë, të ketë edhe qendra kulturore dhe kjo çështje të rregullohet me ligj ose të përcaktohet një minimum i popullsisë shqiptare atje, e cila ka të drejtë për qendër kulturore, që për Gjermaninë do të ishte pak të ketë vetëm një qendër kulturore.

**Time Kadrijaj**, përkrahu procedurën e MDIS, në lidhje me hartimin e këtij projektligji dhe bashkëpunimin e ministrisë me komisionin gjatë debateve publike, në lidhje me këtë projektligj. Gjatë shqyrtimit të këtij projektligji, komisioni do të angazhohet në amendamentimin e tij, duke propozuar që në cilësi të grupit punues, të punojë i tërë komisioni gjatë fazës së shqyrtimit të projektligjit.

**Evgjeni Thaçi-Dragusha**, bëri të ditur se janë ftuar në një konferencë të organizuar nga KDI-ja dhe Drejtoria për Hulumtime e Kuvendit, në lidhje me një hulumtim për qendrat kulturore në diasporë.

**Fitore Pacolli**, theksoi se rëndësia e qendrave kulturore është shumë më e rëndësishme se sa ajo që është paraqitur në letër. Ajo tha se pas një diskutimi me shoqërinë civile, deputetët dhe njohësit e funksionimit të qendrave kulturore, duhet të kemi informata se si ato funksionojnë në Evropë dhe në botë dhe si janë të organizuara. Hulumtimi në fjalë, tha se është lidhur me funksionimin e këtyre qendrave në shtetet e rajonit, por është e interesuar të dijë se si operojnë këto qendra si bie fjala në Armeni, e cila përmes qendrave kulturore ka arritur ta ndërkombëtarizojë çështjen e gjenocidit. Qendrat kulturore të Kosovës tha se duhet të kenë funksion të mbrojtjes së kulturës tonë në rrethin e vet si dhe ta promovojnë atë në rrethin ku ata jetojnë, të krijojnë ndërlidhje me degët e universiteteve për studime albanologjike, studimeve për Ballkanin, të ndërlidhen me akademikë për t'i influencuar ata që të shkruajnë për Kosovën.

Pacolli, tha se nuk jam kundër që të ketë një atashë në qendrat kulturore, por ato duhet të kenë një status tjetër të veçantë, e jo në këtë mënyrë siç është tani i paraparë.

**Elmi Reçica**, shprehu mendimin se është me rëndësi që projektligji i është përcjell Kuvendit dhe se gjatë punës në grupin punues, idetë e paraqitura dhe diskutimet e anëtarëve do të përfshihen në këtë projektligj. Ai njoftoi se ka insistuar që të themelohen Bashkësitë Shqiptare dhe se edhe kjo çështje duhet të jetë për diskutim, se a do të jetë pjesë e ligjit apo jo, pasi që kjo formë e organizimit është provuar dhe ka dhënë rezultate. Reçica tha se qendrat kulturore do të duhej të hapeshin në ato vende ku Kosova ka përfaqësi diplomatike, duke përfshirë Tiranën, Shkupin dhe Podgoricën, meqë në projektligj është propozuar që qendrat të funksionojnë në kuadër të ambasadave. Ai shtoi se pas miratimit të këtij ligji, do të miratohen edhe akte nënligjore, të cilat do të përcaktojnë saktë se cili do të jetë misioni i qendrave kulturore. Reçica tha se komisioni duhet ta miratojë në parim këtë projektligj sepse çështja e diasporës është njëra nga çështjet më të rëndësishme që i ka Kosova.

**Glauk Konjufca**, tha se në këtë projektligj nuk është përfshirë çështja më e rëndësishme e që është marrja e përgjegjësisë nga shteti i Kosovës, sa i përket shkollimit në gjuhën shqipe për gjithë ata që kanë prejardhje prej Kosovës dhe që duan ta ruajnë identitetin, gjuhën dhe kulturën e tyre. Konjufca shtoi se aspekti më i rëndësishëm për të cilin ka nevojë popullata jonë jashtë Kosovës, është mbrojtja e identitetit, kulturës dhe gjuhës për shkak se jetojnë në vende të tjera dhe presioni shoqëror, integrimi, asimilimi janë disa rreziqe sa i përket humbjes së gjuhës e identitetit kombëtar. Ai tha se nëse fëmijët në diasporë nuk e mësojnë gjuhën shqipe dhe nëse Republika e Shqipërisë dhe e Kosovës nuk janë aktive dhe nuk e marrin këtë përgjegjësi, do të humbet resursi më i rëndësishëm, që është resursi njerëzor. Sipas këtij projektligji, njoftoi se Kosova ka përgjegjësi vetëm në shpërndarjen e librave e në hartimin e kurrikulave, por nuk është e paraparë se kush do t'i mësojë nxënësit dhe se kush do t'i paguaj mësuesit. Ai po ashtu njoftoi se gjatë

vizitave të realizuara në diasporë, kanë hasur në 3 kategori të shteteve, sa i përket organizimit të mësimit gjuhës shqipe: kur shteti i mbulon të gjitha shpenzimet, siç është Suedia, është rasti i Gjermanisë ku me disa lande mund të arrihet marrëveshje si dhe ka shtete të cilat nuk mbulojnë asgjë, siç është rasti me Italinë. Në këto shtete tha se është kritike që Republika e Kosovës ti merr përsipër të gjitha obligimet financiare. Sa i përket financimit të organizimit të mësimit në gjuhën shqipe në diasporë, Konjufca tha se ka kërkuar nga ministria ta bëjë një analizë sa i përket shpenzimeve të mundshme, e cila nuk është dërguar, por mund të themi se kjo shifër nuk do të kalojë mbi 15 milionë euro.

**Fitore Pacolli**, tha se projektligji gjatë leximit të tij ta jep sensin e një rezolute, pasi që nuk ka veprime konkrete të cilat i merr përsipër Ministria e Diasporës. Në këtë ligj, tha se ministria e vendos vetën në rolin e ndihmës që do t'i ofrojë diasporës nëpër Evropë, duke i ndihmuar ata që të integrohen në shtetin ku jetojnë, kur dihet se secili shtet i ka politikatat e veta të integritimit të qytetarëve, brenda sistemit të vet politik, arsimor dhe social. Duke iu referuar nenit 24 të projektligjit, që ka të bëjë me bashkëpunimin në fushën e sportit, tha se ky nen duhet të hiqet pasi që kjo çështje nuk është punë e ministrisë. Ajo më tej tha se projektligji ka shumë gjëra që duhet të ndryshohen dhe është problem të ndryshohet në lexim të dytë ose gjatë diskutimeve që bëhen në komision.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, në lidhje me mospërfshirjen e rekomandimeve të komisionit në projektligj, njoftoi se komisioni i ka dy mundësi; ta ftojë ministrin në mbledhjen e radhës, ku do të diskutoheshin këto gjëra ose ta miratojë në parim këtë tekst të projektligjit dhe pastaj në mes të dy leximeve ta ftojë ministrin dhe ta organizojë një tryezë e përbashkët me shoqërinë civile. Ajo më tej shtoi, se çështja e financimit të shkollimit, çështja e programit televiziv duhet të jetë amendament i këtij komisioni. Propozoi që grupi punues për amendamentimin e këtij projektligji të përbëhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, dhe që deputetja Pacolli të hartojë amendamente në lidhje me qendrat kulturore, deputeti Konjufca të hartojë amendamente në lidhje me çështjen e shkollimit dhe deputetja Maloku të hartojë amendament në lidhje me pjesën e programit televiziv, kurse deputetja Thaçi, meqenëse e ka mbikëqyrë zbatimin e ligjit, të propozojë amendamente për çështje tjera që mendon se kanë mbetur jashtë këtij projektligji.

**Time Kadrijaj**, shprehu mendimin se komisioni duhet ta miratojë në parim këtë projektligj dhe se në mes të dy leximeve mund të adresohen çështjet e ngritura.

**Elmi Reçica**, tha se komisioni do të duhej ta miratonte në parim këtë projektligj dhe në mes të dy leximeve të amendamentohet. Ai shtoi se meqë është i gjithë komisioni në grup punues, nuk do të ketë probleme që propozimet e anëtarëve të shndërrohen në amendamente.

**Fitore Pacolli**, shprehu mendimin se pasi që projektligji do të ketë nevojë të ndryshohet në mbi 50%, është më mirë të ftohet ministri, në mënyrë që të shtyhen disa ndryshime përmes tij.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, rreth kërkesës së deputetes Pacolli, njoftoi se sipas procedurave të Kuvendit, ministri nuk mund ta ndryshojë më ligjin, përveç nëse e tërheq atë. Ajo, po ashtu njoftoi se nëse komisioni insiston ta kthejë ligjin mbrapa, do të krijohen vonesa të mëdha, pasi që për momentin nuk ka qendra kulturore funksionale, dhe se është më mirë të ndryshohet projektligji në mes të dy leximeve. Ajo propozoi që lidhur me këtë projektligj të organizohet një dëgjim publik me shoqërinë civile si dhe të ftohet ministri gjatë amendamentimit të projektligjit.

Pas diskutimeve, kryetarja konstatoi se komisioni nxori këtë:

#### *Përfundim*

*Miratohet në parim Projektligji nr. 06/L-148 për Diasporën, me 7 vota "Për" dhe 2 "Abstenim".*

#### 4. Të ndryshme.

**Time Kadrijaj**, kërkoi që komisioni ta formojë një grup punues për amendamentimin e Projektligjit për Dialogun, pasi që është miratuar në parim në seancë plenare. Ajo propozoi që deputeti Gorani ta udhëheqë atë grup punues.

**Vjosa Osmani-Sadriu**, propozoi që të respektohet parimi i njëjtë sikur me Projektligjin për Diasporën, që grupi punues të jetë në përbërje të plotë të komisionit. Në momentin kur përfundon afati për paraqitjen e amendamenteve, ato do të shqyrtohen dhe pastaj projektligji i procedohet Kuvendit për shqyrtim të dytë.

Ajo po ashtu njoftoi se ministri Pacolli është ftuar për ta vazhduar raportimin deri më datën 12 shkurt 2019 dhe se zyra e tij ka njoftuar, se ai nuk mund të vijë para datës 20 shkurt 2019.

Mbledhja përfundoi në orën 13:50.

Kryetarja e Komisionit,

---

Vjosa Osmani-Sadriu

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.